

# RAPORT MBI VËZHGIMIN E KRYER NË INSTITUCIONET E EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE PENALE DHE ATO TË PARABURGIMIT

## Hyrje

**Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH)**, organizata e parë e të drejtave të njeriut e krijuar në vitin 1990 ka për mision mbrojtjen, edukimin dhe sensibilizimin e opinionit publik dhe të organeve shtetërore për një respektim më të mirë të të drejtave të shtetasve. Monitorimi i respektimit të të drejtave të personave të arrestuar, të paraburgosur dhe të dënuar në institucionet penitenciare, prej vitesh ka qenë në vemendjen e veçantë të KSHH-së.

Gjatë muajit korrik 2009, KShH kreu disa misione vëzhgimi në institucionet e paraburgimit: **“Jordan Misja” në Tiranë, “Mine Peza” në Tiranë, Sarandë, Berat, Durrës, Vlorë**, si edhe Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve me Burgim **“Shën Koll” Lezhë, Vaqarr, Burrel, “Ali Demi”, Tiranë dhe Spitali i Burgjeve në Tiranë**<sup>1</sup>.

**Disa nga objektivat kryesore të këtyre misioneve ishin:** vëzhgimi i kushteve të jetesës së personave të privuar nga liria në institucionet penitenciare; vëzhgimi i respektimit të të drejtave të këtyre personave nga personeli i administratës së institucionit; verifikimi në vend i ankesave dhe shkeljeve të pretenduara nga personat e privuar nga liria si dhe ofrimi i konsulencës juridike për ata persona që kishin mungesë të informacionit ligjor dhe që për shkaqe të ndryshme nuk kishin avokat.

Në vëzhgim morën pjesë grupi i ekspertëve të KSHH-së dhe stafi i tij. Metodologjia e përdorur në këto vëzhgime është: marrja e takimeve me përfaqësues të administratës të institucioneve dhe me personelin e administratës të sektorit shëndetësor, edukativ dhe juridik, vëzhgime në terren i ambjenteve, pajisjeve, ushqimit dhe medikamenteve në institucionet penitenciare, intervista dhe takime me të dënuar dhe të paraburgosur.

Gjatë vëzhgimeve u mbajtën parasysh standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të përcaktuara në legjislacionin e adoptuar nga shteti shqiptar, lidhur me të drejtat dhe kushtet e jetesës së personave të privuar nga liria.

---

<sup>1</sup> Misionet e monitorimit janë mundësuar falë mbështetjes financiare të Komitetit Suedez të Helsinkit në kuadër të programit “Për një respektim më të mirë të të drejtave të viktimave në Shqipëri- Klinika ligjore 3”

## 1. Infrastruktura dhe kushtet fizike

Gjatë vëzhgimeve u vu re se përsa i takon infrastrukturës, problematikat e evidentuara në vëzhgimet e mëparshme të KShH-së vazhdojnë të jenë akoma ekzistente.

**Disa institucione kanë nevojë emergjente për rikonstruksione për shkak të amortizimit** të ambjentëve, lagështirës, etj dhe konkretisht mund të përmëndim: Institucionet e paraburgimit *Mine Peza, Sarandë dhe Berat, Institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale Ali Demi, "Vaqarr", Burrel dhe Spitali i Burgut.* Pavarësisht se në disa Institucione ishte parashikuar të fillonin procedurat e rikonstruksionit para disa muajsh, kjo nuk ishte bërë e mundur për shkak të procedurave të tenderimit, konkretisht Institucioni i paraburgimit Sarandë pritej që para 2 vitesh të fillonte rikonstruksioni por ende nuk ka filluar. E njëjta situatë paraqitet në I EVP Ali Demi dhe I EVP Burrel.

Për t'u vlerësuar është fakti se në institucionin e Vlorës, ***me urdhër të DPB-së ishte krijuar një seksion i ri për jeane adultët (18 – 21 vjeç) të cilët qëndronin në dhoma të veçanta.***

Disa nga problemet e vërejtura në këto institucione ishin ***prania e lagështirës, mungesa e ndriçimit natyror, muret e palyera dhe të pasuvatuara.***

Vlen të përmendet si shembull i mirë, sa i takon kushteve të shumë të mira të infrastrukturës, institucioni i paraburgimit Vlorë, i cili plotësonte standartet e përcaktuara. Por pavarësisht nga kjo, tavanët e godinës të këtij institucioni kishin nisur të pikonin për shkak të dëmtimit të soletave, pasi çdo institucion ka nevojë për mirëmbajtje të vazhdueshme.

Megjithatë, edhe pse disa nga institucionet e vëzhguara ishin të reja ose ishin rikonstruktuar së fundmi, godinat e tyre kishin lagështirë si: Institucioni i Paraburgimit Durrës dhe burgu i Shën Kollit. Edhe pse vëzhgimi u krye në stinën e verës, disa nga muret e këtyre godinave pikonin duke shkaktuar rënie të suvasë. Ambjentet e jashtme të burgut Shën Koll kishin probleme me prishjen e tubacioneve të ujrave të zeza.

Tepër problematike ***paraqitej mungesa e furnizimit me ujë dhe energji elektrike*** në institucionin e paraburgimit Durrës dhe mungesa e ujit në institucionin e paraburgimit të Vlorës. Për shkak të stinës së verës dhe temperaturave shumë të larta furnizimi me ujë i këtyre institucioneve ishte thelbësor për përmbushjen e nevojave jetësore të personave të paraburgosur.

Në gjendje shumë të vjetëruar ishin ***pajisjet e përdorimit vjetjak si dyshekë, çarçafë, jastëk dhe/ose krevate.*** Kjo u vërejt veçanërisht në Paraburgimin Mine Peza, në I EVP Vaqarr dhe në Spitalin Burgut.

Ajo çfarë u vërejt gjatë vëzhgimit të kryer në Institucionin e paraburgimit Durrës ishte mosvënia në funksionim të institucionit për të sëmuret mendore, i cili nuk merret në dorëzim nga Ministria e Shëndetësisë dhe ka kohë që është ndërtuar dhe janë përfunduar punimet.

## 2. Kushtet higjieno-sanitare

Pavarësisht konstatimeve dhe rekomandimeve të vazhdueshme të KShH-së për përmirësimin e kushteve higjieno-sanitare, ato vazhdojnë të përbëjnë problem në shumicën e institucioneve të vëzhguara. Kushte jo të mira higjieno-sanitare u vërejtën në institucionet e paraburgimit *‘Mine Peza’, Jordan Misja, Durrës dhe institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale “Vaqarr”, “Shën Koll”, Burrel dhe Spitalin e Burgut.* Mungesa e ujit në stinën e verës dhe mungesa e detergjentëve në disa institucione përkeqësonte këto kushte. Prania e furrtaeve të zeza në I.E.V.P Vaqarr dhe ankesat e të dënuarve për praninë e minjve në I.E.V.P Burrel ishin tepër shqetësuese.

Në institucionin e Paraburgimit të Beratit u vu re **mungesa e një sanitari në organikën e institucionit**, duke bërë kështu që pastrimi në këtë institucion të kryhej nga oficerët e policisë.

Duke qenë se në disa institucione pastrimi i ambienteve të dhomave iu ishte lënë vetë personave të privuar nga liria, shihet si tepër e nevojshme edukimi higjieno-sanitar i tyre si dhe herë pas here dizinfektimi i ambienteve të këtyre institucioneve..

### 3. Mbipopullimi

Gjatë vëzhgimit u vu re se vazhdonte të kishte mbipopullim pothuajse në të gjitha institucionet e vëzhguara. Konkretisht kjo u vu re në institucionet e paraburgimit Mine Peza, Jordan Misja, Vlorë, Berat dhe në IEVP-të Vaqarr, Burrel dhe Spitalin e Burgut.

Mbipopullimi në Institucione shkakton dhe mosrespektim të të drejtave të personave të paraburgosur dhe personave të dënuar. Kapacitet mesatarisht i lartë i personave për dhomë u konstatua në sektorin e grave në institucionin e paraburgimit “Jordan Misja” (2-5 persona në dhomë) dhe në burgun e Vaqarrit (4-6 persona). Shumë problematike paraqitej gjendja në burgun e Burrelit ku në disa dhoma me kubaturën për 4 persona, qëndronin mesatarisht 6-10 persona dhe në institucionin e paraburgimit Berat ku për shkak të mbipopullimit në dhoma, të paraburgosurit flinin me dyshekë në tokë.

### 4. Organika

Nga vëzhgimi rezultoi se pjesa më e madhe e institucioneve të vëzhguara kishin mungesë personeli, kryesisht ata të sektorëve të shërbimit mjekësor dhe atij edukativ. ( sakteso, a jane ne organike ata qe mungojne ?) Në institucionet e paraburgimit Durrës, Vlorë, Berat dhe Sarandë<sup>2</sup> **mungonte mjeku stomatolog.** Në Spitalin e burgut mungonte **mjeku neurolog dhe mjeku kardiolog, i cili ishte i punësuar me kohë të pjesshme.**

Gjithashtu disa institucione paraburgimi si Saranda dhe Berati **nuk kishin farmacist.** I.P “Jordan Misja” nuk **kishte mësues për të miturit** ndërsa **I.P Sarandë nuk kishte psikolog.** Në I.E.V.P Burrel dhe I.P Sarandë **mjeku punonte me kohë të pjesshme.**

---

<sup>2</sup> Në institucionin e paraburgimit Sarandë të dënuarit dhe të paraburgosurit që kishin nevojë për shërbime stomatologjike dërgoheshin pranë klinikave private. Në disa raste një pjesë e këtyre shpenzimeve mbulohej nga vetë institucioni.

## 5. Ajrimi

Në shumicën e institucioneve, respektohej minimumi ligjor i orëve të ajrimit, duke përfshirë dhe ajrimin 2 herë në ditë, paradite dhe mbasdite. Megjithatë në disa institucione kushtet infrastrukturore nuk mundësonin ajrim të përshtatshëm të personave të dënuar. Por ajo çfarë u vu re në disa institucione gjatë vëzhgimit ishte se ajrimi nuk bëhej në ajër të pastër, por personat e privuar vendoseshin në një dhomë tjetër pak më të madhe e cila shërbente për të bërë ajrimin. Dhomat e ajrimit ishin tepër të vogla ose nuk plotësonin kushtet minimale për një ajrim të përshtatshëm dhe kjo u re në Institucionin e paraburgimit “Jordan Misja”, Sarandë dhe I.E.V.P Burrel.

## 6. Shërbimi shëndetësor

Monitorimi i shërbimit shëndetësor në institucionet penitenciare, ishte në fokusin e veçantë të ekspertëve të KShH-së.

Përgjithësisht në të gjitha institucionet e vëzhguara shërbimi shëndetësor ofrohej 24 orë. Pavarësisht nga kjo, *shërbimi shëndetësor ofrohej jo në mënyrë periodike por sipas kërkesave të personave të privuar nga liria*. Nga vëzhgimet u vunë re se në disa institucione *mjeku punonte me kohë të pjesshme* duke shkaktuar kështu mungesën e shërbimeve shëndetësore tek personat në këto institucione. Konkretisht kjo u vërejt në Institucionin e Sarandës dhe IEVP Burrel. Mungesa janë vënë re në personelin mjekësor<sup>3</sup>.

Në *I.P “Jordan Misja” kishte mungesa të aparaturave të nevojshme mjekësore-stomatologjike* ndërsa nga kontaktet direkte me gratë e dënuara rezultoi se nuk i nënshtroheshin vizitave gjinekologjike, në mënyrë periodike.

Ambjentet e urgjencës në I.P Berat<sup>4</sup> nuk plotësonin kushtet minimale të nevojshme. Institucioni i paraburgimit Berat dhe Sarandë nuk kishte as dentist dhe as pajisje stomatologjike ndërsa ai i Vlorës dhe i Durrësit nuk kishin autoambulancë. Nga vëzhgimi rezultoi se IEVP Vaqarr nuk kishte mundësi financiare për të përballuar kryerjen e analizës skaner, që kërkohej nga institute të Mjekësisë Ligjore.

KShH mori ankesa përse i takon shërbimit mjekësor në institucionin e paraburgimit “Mine Peza”, “Jordan Misja”, Durrës, dhe IEVP Burrel.

Në Institucionet e vëzhguara u kontaktuan disa përdorues, prej disa vitesh, të lëndëve narkotike, të cilët ishin jo në gjëndje të mirë shëndetësore. Institucionet e vuajtjes së dënimit dhe ato të paraburgimit nuk kishin programe të specializuara për këtë lloj

<sup>3</sup> Shih me shumë pikën 4 “Organika” në këtë raport

<sup>4</sup> Dhoma ndihmës së shpejtë në I.P Berat nuk kishte dyshek, por vetëm një krevat me sustë dhe përdorej edhe për takimet me familjarët

kategorie, kjo ishte më e dukshme në I.P Durrës<sup>5</sup>, I.P të Sarandës<sup>6</sup>, IEVP Burrel, I.P Berat (70% e personave të paraburgosur në këtë institucion ishin përdorues të lëndëve narkotike). Nga kontaktet me administratën e Institucionit të paraburgimit të Beratit rezultoi se mbas daljes së këtyre personave nga institucioni, ndaj tyre nuk aplikoheshin programe rehabilitimi dhe ata ktheheshin përsëri në të njëjtat kushte duke bërë kështu dhe kthimin në recidivist në kryerjen e veprave penale të ndryshme.

Në Institucionet e Paraburgimit Durrës kishte persona që vuanin nga sëmundje, si epilepsia, për të cilët nuk mund të ofrohej trajtim i specializuar dhe për këtë arsye kërkohej transferimi i tij në një institucion tjetër të specializuar.

Në I.E.V.P “Vaqarr”, nga kontaktet me personat që qëndronin në këtë institucion, kishte persona që vuanin nga sëmundja e sheqerit në gjak të cilët i ishin nënshtruar analizës së matjes të nivelit të sheqerit në gjak para një viti, duke shkaktuar kështu mosofrimin e shërbimit shëndetësor të detyruar në këto institucione.

**Lidhur me medikamentet**, të gjitha institucionet kishin farmacitë të cilat furnizoheshin rregullisht me medikamente. Një shkelje e hapur që u vu re ***në I.P Berat, ishte mungesa e ambjenteve fizike të veçanta për farmacinë***, si dhe mbajtjen e medikamenteve. Raftet me medikamente ishin të vendosura në korridor. Farmacisti mungonte dhe ky shërbim kryhej nga një infermier dhe nuk kishte rregull për shpërndarjen e ilaceve. Vlen të përmëndim një shëmbull pozitiv lidhur me mbajtjen dhe shpërndarjen e medikamenteve siç është Paraburgimi i Vlorës.

Përsa i takon gjendjes së farmacive në institucionet e vëzhguara, u vërejt se ato kishin në gjendje medikamente mjekësore. ***Pengesë ishte mosrealizimi i tenderit të blerjeve të ilaçeve në shumë institucione***, megjithatë nevojat përmbusheshin nëpërmjet blerjeve nga vetë institucioni të cilat realizoheshin nga fondi i blerjeve të vogla.

Dhe institucioni i Spitalit të Burgut si një institucion i specializuar mjekësor realizonte blerjet për nevojat shëndetësore të të sëmurëve nga fondi i blerjeve të urgjencës pasi tenderi nuk ishte realizuar ende.

Farmacitë e paraburgimit të Vlorës dhe institucionit Vaqarrit ishte në gjendje shumë të mirë me ilaçet të cilat ishin mëse të mjaftueshme dhe brenda afatit të skadencës.

Nga vëzhgimi në vënd i gjendjes fizike të farmacisë dhe medikamenteve, rezultoi se në disa nga institucione të vëzhguara si ***I.P “Jordan Misja”, Berat dhe IEVP Burrel disa nga medikamentet ishin të skaduara***. Për këtë grupi vëzhgimit ka bërë vërejtet e veta Institucionit për të cilat ka marrë përgjigje se është informuar dhe Drejtoria e

---

<sup>5</sup> Një i paraburgosur, i cili u kontaktua nga grupi i vëzhgimit, ishte përdorues i lëndëve narkotike prej më shumë se 10 vjetësh. Ai rezultonte të ishte në gjendje jo të mirë shëndetësore, këmbët i kishte të enjtura dhe me ngjyrë vishnje në të zeze dhe nuk ecte dot

<sup>6</sup> Nga kontaktet me një person të paraburgosur, rezultoi një përdorues droge i cili qëndronte prej 2 javësh në dhomën e izolimit, kushtet e së cilës ishin të këqija. Ai flinte me dyshekë në tokë, nuk dilte në ajrim dhe askush nuk e vizitonte.

përgjithshme e Burgjeve por nuk është bërë asgjësimi ose tërheqja e këtyre medikamenteve.

## **7. Kategoria e të sëmurëve mendorë**

Të sëmurët mendorë si një kategori e cila kërkon një trajtim të specializuar shëndetësor dhe psikiatrik duhet të vendosen në Institucione të specializuara.

**Problem sot mbetet numri i madh i kësaj kategorie në institucionet të paraburgimit dhe Institucionet e vuajtjes së dënimit** të cilët jo vetëm që nuk ofrojnë një shërbim shëndetësor të specializuar por nuk kanë të punësuar as ndonjë psikiatër. Pothuajse në të gjitha institucionet e vëzhguara, në radhët e personave të dënuar dhe të paraburgosur kishte të sëmurë mendore.

Spitali i Burgut është institucioni që ka numrin më të madh të sëmurëve mendorë, afërsisht 113 të sëmurë<sup>7</sup>, nga të cilët 100 persona ishin me masë mjekësore “Mjekim i detyruar”, 11 persona ishin me masën e sigurimit ‘mjekim i përkohshëm në një spital psikiatrik’ dhe 3 persona ishin të burgosur që ishin transferuar në Spitalin e Burgut për shkak të problemeve akute psikiatrike. Mbatja e të sëmurëve mendorë në Spitalin e Burgut dobëson rolin e këtij institucioni si një spital për trajtimin e sëmundjeve të përgjithshme për personat e privuar nga liria. Spitali i burgut nuk i ka kapacitetet e një spitali psikiatrik.

*Institucione të tjera me një numër të konsiderueshëm personash të sëmurë mendore* ishin paraburgimi ‘Jordan Misja’ (13 të sëmura mendore), Vlora (15 të sëmurë mendore) dhe institucioni i Shën Kollit (10 të sëmurë mendore), Berat (2), etj. Shumë kritike paraqitej gjendja në institucionin e paraburgimit Berat, ku mbaheshin 2 persona të paraburgosur (endacakë) me sëmundje mendore të cilët kryenin nevojat personale në rroba dhe kishin kohë që nuk ishin larë, duke u bërë kështu rrezik për përhapje infeksioni. Dhoma ku këta persona mbaheshin, ishte me kushtet më të këqija, për shkak dhe të mosmbajtjes së higjienës personale nga vetë ata. Shumë nga veprimet që duhet të kryheshin nga një sanitar në dhomën e tyre kryhej nga efektivët e policisë duke përbërë rrezik në radhë të parë për shëndetin e tyre.

*Transferimi i të sëmurëve mendorë në institucionet e specializuara për këto sëmundje*, si Institucioni për trajtimin e të sëmurëve mendore në Paraburgimin e Durrësit dhe Institucionit të veçantë të Zaharisë, Krujë, mendojmë se **është një hap i domosdoshëm për të garantuar një trajtim mjekësor të specializuar për këta persona dhe për lehtësimin e punës të vetë administratës të këtyre institucioneve.**

## **8. Kujdesi psiko – social dhe planet edukuese**

Lidhur me kujdesin psiko-social dhe planet edukuese për personat e paraburgosur dhe ata të dënuar, çdo institucion ndiqte programet e tij.

---

<sup>7</sup> Numër i cili i referohet datës së vëzhgimit në këtë institucion, konkretisht datë 9 korrik 2009

Nga vëzhgimi i kryer disa Institucione si *IP Vlorë dhe I EVP Ali Demi, rezultoi se kishte programe mujore dhe individuale ditore* për secilin person të paraburgosur ose të dënuar. Në IP Vlorë për seksionin e të miturve dhe jeane adultët (18 – 21 vjeç), ishin përgatitur programe të specializuara si dhe zbatoheshin me rigorozitet<sup>8</sup>.

Ndërsa në *Paraburgimet e Sarandës dhe Beratit si dhe në I.E.V.P Burrel, të cilat për shkak të mungesës së kapaciteteve infrastrukturore ose të stafit kishin mangësira në hartimin dhe zbatimin e programeve sociale, planeve mujore dhe individuale*. Edhe në ato raste kur këto programe ishin hartuar, ato ishin standarte dhe nuk ishin të lidhura me veçoritë individuale të personave dhe nevojat e tyre fizike dhe emocionale.

Zhvillimi i kurseve profesionale duhet të shikohet me shumë përparësi nga institucionet penitenciare, për të mundësuar riintegrimin e personave të privuar nga liria në tregun e punës, mbas daljes nga institucioni. Në disa institucione, përveç *kurseve të kompjuterit dhe të gjuhës së huaj që aplikoheshin në disa institucione, nuk zhvilloheshin kurse të tjera profesionale*.

Nga vëzhgimi i realizuar, u konstatua se alternativa e vetme për kalimin e kohës së lirë për personat e privuar nga liria ishin ato me karakter sportiv të cilat realizoheshin disa herë në javë. Shumë nga personat e kontaktuar u ankuan për mungesën e aktiviteteve me karakter edukativ dhe sportiv, kryesisht në I EVP Burrel, IP Berat dhe Sarandë.

Ndryshe ndodhte në IP Vlorë, ku për shkak të infrastrukturës së re, të paraburgosurit përdornin palestrën e cila ishte në kushte shumë të mira, zhvillonin lojëra të tjera si pingpong, shah, kompjutera, etj.

Kurset për mësimin e analfabetëve aplikoheshin në të gjitha institucionet e vëzhguara. Megjithatë, marrëveshja midis Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe Ministrisë së Arsimit për organizimin e shkollës për të miturit dhe analfabetët kishte gjetur zbatim vetëm në institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale Vaqarr. Në Institucionin e Ali Demit, marrëveshja nuk mund të gjente zbatim për shkak të infrastrukturës së papërshtatshme të këtij institucioni.

Mungesa e bibliotekës në disa nga institucionet e vëzhguara ( institucioni i paraburgimit Sarandë, Berat dhe I.E.V.P Burrel), përbën problem shqetësues sa i takon kalimit të kohës së lirë dhe edukimit të personave të dënuar/paraburgosur. IP Vlorë kishte një bibliotekë të pasur me libra të ndryshëm dhe një sistem kartelash për çdo person të paraburgosur.

## 9. Transferimet

Kryesisht, në të gjitha institucione e paraburgimit të vëzhguara *kishte vonesa në transferimin e personave të dënuar me vendim të formës së prerë në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale*. Nga verifikimet e kryera rezultoi se arsye te këtyre

---

<sup>8</sup> Gjatë vëzhgimit të kryer në Institucionin e Paraburgimit Vlorë, grupi i vëzhgimit ishte i pranishëm gjatë zbatimit të programeve edukuese me të miturit që qëndronin në këtë institucion.

vonesave ishin: *moskalimi i vendimeve gjyqësore nga gjykata në prokurori, vonesa në daljen e urdhërit të ekzekutimit të prokurorisë por edhe vonesa në caktimin e institucionit të vuajtjes së dënimit nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve*

Kryesisht në të një pjesë të rasteve të identifikuar nga grupet e vëzhgimit transferimet nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve bëhej në jo më pak se 15 ditë.

Në institucionin e paraburgimit Sarandë, në kundërshtim me ligjin, persona me vendim gjyqësor të formës së prerë të cilëve u kishte ngelur deri në 2 muaj nga vuajtja e dënimit, mbaheshin në dhomat e paraburgimit për të qenë afër familjes. Kjo gjë ndodhte dhe në Paraburgimin Durrës.

## 10. Ushqimi

Ambjentet e gatimit të institucioneve penitenciare ishin gjithashtu objekt i vëzhgimit tonë. *Norma ushqimore që iu ofrohej personave të dënuar dhe paraburgosur respektohej, gjithashtu, dhe menyuja ditore ishte e larmishme.* Megjithatë për shkak të mentalitetit të personave të privuar nga liria, ushqimi konsumohej në nivele të ulëta, kryesisht një pjesë e të paraburgosurve preferonin ta merrnin ushqimin nga shtëpia. Të dënuarit dhe të paraburgosurit në institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale “Burrel” vazhdonin të ankoheshin për cilësinë e ushqimit që ju ofrohej.

Nga vëzhgimi në vend rezulton se *ambjentet e gatimit në përgjithësi janë të mira ku respektohet higjiena në gatim. Shumë të mira paraqiten kushtet e ambjenteve të gatimit në IP Vlorë,* e cila ishte e pajisur gjithashtu dhe me pajisjet frigoriferike për mbajtjen e ushqimit.

Ambjentet e gatimit të paraburgimit të Beratit për shkak të mungesës së infrastrukturës dhe ambjenteve ndodhej në godinën e Komisariatit të Beratit.

*Shqetësuese vazhdon të qëndrojnë kushtet në të cilët personat e privuar nga liria konsumojnë ushqimin e Institucionit ose familjes si dhe e ruajnë atë,* sidomos kur temperaturat janë të larta dhe jo të gjitha dhomat janë të pajisuara me frigorifer.

*Shqetësues ishte fakti se në institucionin e Vlorës dhe në i.e.v.p “Vaqarr” nuk aplikohet dietë ushqimore e veçantë për të sëmurët diabetikë.*

## 11. Të tjera

Në të gjitha institucionet e vëzhguara, **personat e privuar nga liria ishin të angazhuar në punë të ndryshme.** Më shumë persona të paraburgosur ose të dënuar të punësuar kishte IEVP Vaqarr, Burrel, IP Durrës, etj.

Në *IEVP Burrel vazhdon ende të mbetet shqetësim mosnjohja e ditëve të punës* nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor për shkak të një udhëzimi të nxjerë nga Prokuroria. Kjo praktikë nuk ndiqej nga gjykatat e rretheve të tjera gjyqësore.

Lidhur me **mekanizmin kërkesë-ankesë**, nëpërmjet të cilit personave të privuar nga liria, sipas legjislacionit në fuqi, duhet t’i krijohet mundësia që çdo ditë të paraqesin kërkesë-ankesa në administratën e institucionit, ose të kërkojë takim me drejtorin e IEVP ose personelin përgjegjës, *u konstatua se nuk respektohej afati ligjor brenda të cilit administrata e institucionit është e detyruar t’i kthejë përgjigje personit.* Shumë ankesa për mosrespektimin e këtij afati u ngritën nga të paraburgosurit e institucionit të Durrësit.



**Ambientet e takimit me familjarët** në institucionet e paraburgimit Sarandë dhe Berat *ose mungonin ose ishin të papërshtatshme dhe vështirësonin fizikisht dhe emocionalisht takimin e personave me familjarët e tyre.* Shumë ankesa u ngritën nga të miturit e institucionit të Shën Kollit, pasi familjarët e tyre nuk interesoheshin për ta. Mbështetja e vazhdueshme psiko-sociale nga familja është thelbësore për të miturit në mënyrë që të minimizojë efektet negative të qëndrimit në mjedise të mbyllura. Për këtë arsye është shumë i rëndësishëm hartimi i programeve për të mundësuar mbajtjen e kontakteve mes të miturve dhe familjarëve të tyre.

## 12. Problemet gjyqësore

Një numër i konsiderueshëm ankesash të personave të privuar nga liria i adresoheshin sistemit gjyqësor.

**Problemet e ngritura ishin:** dhënia e masave të sigurimit nga gjykata “arrest me burg” në rastet kur personat nuk paraqesnin rrezikshmëri të lartë ose ishin funksionarë publikë; zvarritja e proceseve gjyqësore të çështjeve për të cilët të paraburgosurit akuzohen, si dhe për kërkesa të ndryshme lidhur me uljen e dënimit, njohjen e ditëve të punës, etj., moskorrektësia e veprimeve të avokatëve me klientët, sidomos avokatët kryesisht, duke përfshirë këtu mungesën e takimeve të avokatëve me klientët, mosinformimi për zhvillimin e proceseve gjyqësore, kërkimin e rryshfeteve në “emër” të gjyqtarëve ose prokurorëve, etj.

Zvarritja e proceseve gjyqësore është veçanërisht problematike për të miturit, të cilët për shkak të moshës së tyre dhe efekteve negative të qëndrimit në mjedise të mbyllura, kanë nevojë për gjykime sa më të shpejta dhe efektive.

Duke u nisur nga kontaktet me të miturit në Paraburgimin e Vlorës, Jordan Misja dhe Shën koll, Lezhë si dhe nga studimi i dosjeve të tyre, rezultoi se shumica e të miturve të cilët ishin akuzuar për veprën penale të vjedhjes, qëndronin në Institucionet e paraburgimit për më shumë se 3-4 muaj<sup>9</sup>. Në kohën e vëzhgimit në pak raste kishte filluar aplikimi i dënimeve alternative për të miturit.

Shumë problematike paraqitej gjendja në Spitalin e burgut sa i takon personave ndaj të cilëve gjykata, ka dhënë “mjekim i detyruar në një institucion mjekësor”. Në përputhje me nenin 46 të Kodit Penal, gjykata, kryesisht është e detyruar që pas kalimit të një viti nga dita e dhënies së vendimit, të marrë në shqyrtim vendimin e saj, detyrim ky që nuk është zbatuar në praktikë për të sëmuret me masë mjekësore në Spitalin e Burgut. Për këtë Komiteti Shqiptar i Helsinkit ka reaguar disa herë për vite me rradhe duke

---

<sup>9</sup> Në një nga paraburgimet e vëzhguara, i mituri me iniciale A.D mbahej në paraburgim prej 23 muajsh dhe procesi i tij ende s’kishte përfunduar

ndërgjegjësuar institucione si Gjykatat e rretheve gjyqësore dhe Këshillin e Lartë të Drejtësisë<sup>10</sup>.

### **13. Konsulenca ligjore**

Duke qenë se një ndër objektivat e misionëve të vëzhgimit ishte edhe ofrimi i konsulencës ligjore për personat në nevojë, KSHH nëpërmjet grupeve të vëzhgimit ofroi këshillime ligjore duke i informuar personat e privuar nga liria lidhur me dënimet alternative dhe ligjin për shërbimin e provës, afateve të paraburgimit, mjeteve ligjore të ankimit të vendimeve gjyqësore, gjykimin e shkurtuar etj.

#### **Rekomandime drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe Ministrisë së Drejtësisë:**

1. T'u lihet në dispozicion, Institucioneve të paraburgimit dhe vuajtjes së dënimit një fond i cili të shërbejë për mirëmbajtjen e institucioneve në mënyrë të vazhdueshme në rastet e amortizimit.
2. Të bëhet një kontroll më i mirë i punimeve që kryhen në burgje, përpara se të merren në dorëzim, me qëllim shmangien e problemeve në vazhdimësi.
3. KSHH rekomandon se duhet të shihet me prioritet marrja e masave për rikonstruksionin e disa godinave të cilat paraqiten problematike, konkretisht I.P Sarandë, Berat, Mine Peza dhe I EVP-të Ali Demi, Vaqarr, Burrel dhe Spitali i Burgut.
4. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve (DPB) së bashku me Drejtoritë e Burgjeve të paraburgimit Vlorë dhe Durrës të koordinojnë me komunat dhe bashkitë përkatëse për furnizimin me ujë.
5. Rekomandohet të bëhet zëvendësimi në të reja të pajisjeve të përdorimit vetjak si dyshekë, çarçafë, jastëk, krevatë, sidomos në Institucionet Mine Peza, I EVP Vaqarr dhe Spitali i Burgut.
6. Koordinimi ndërmjet DPB-së dhe Ministrisë së Shëndetësisë për vënien në punë e seksionit të ngritur pranë Institucionit të paraburgimit Durrës për personat e çrregullime mendore dhe transferimin sa më shpejtë të tyre në këtë Institucion.
7. Rekomandojmë DPB-së që të shtohet një sanitar në organikën e Institucionit të Paraburgimit të Beratit për mirëmbajtjen e ambjenteve të përbashkëta duke bërë kështu të mundur që forcat e policisë të kryejnë detyrat që u takojnë me ligj.
8. Të përmirësohen kushtet higjieno sanitare si dhe të bëhet dizinfektimi i ambjenteve të institucioneve të paraburgimit dhe I EVP-ve, sidomos në I EVP Vaqarr dhe Burrel.

---

<sup>10</sup> Gjatë vëzhgimit në Spitalin e Burgut, KSHH identifikoi një rast të një personi që paraqiste çrregullime mendore, i cili kishte më shumë se tre vjet, që qëndronte në këtë institucion me masën e sigurimit "shtrim i përkohshëm në një spital psikiatrik", dhënë nga gjykata më 03/03/2006. Vepra penale për të cilën personi ishte akuzuar, ishte duke u gjykuar në Gjykatën e Shkallës së Parë. Sipas personelit të institucionit, çështja e tij ishte lënë në harresë. Personi nuk kishte avokat mbrojtës dhe nga kontakti që patëm me të, u informuam se ai nuk kishte as familjarë.

9. KSHH rekomandon DPB-së dhe Institucioneve përkatëse për plotësimin e organikës ose shtimin e tij për mungesat e vërejtura gjatë vëzhgimeve, konkretisht mjekut stomatolog në institucionet Durrës, Berat, Vlorë dhe Sarandë; të mjekut neurolog dhe kardiolog në institucionin e Spitalit të Burgut; të farmacistit në Institucionin e Beratit dhe Sarandës; të mësuesit për të miturit në Institucionin Jordan Misja; të psikologut në IP Sarandë, si dhe punësimin e një mjeku me kohë të plotë në Institucionet Sarandë dhe Burrel, një juristi në Institucionin e Durrësit.
10. Përmirësimi i kushteve lidhur me ambjentet e ajrimit të personave të privuar nga liria në ambiente më të përshtatshme të jashtme dhe jo në dhoma të improvizuara, sidomos në Institucionet “Jordan Misja”, Sarandë dhe Burrel.
11. Rekomandojmë Institucionin “Jordan Misja” të organizojë herë pas here kryerjen e vizitave gjenekologjike në mënyrë periodike.
12. Duhet plotësuar mungesat e institucioneve me aparatura të nevojshme mjekësore-stomatologjike, me mjetet e nevojshme si ambulancat në Durrës dhe në Vlorë, si dhe përmirësimin e kushteve të ambjenteve të urgjencës në Institucionin e Beratit.
13. Krijimi i ambjenteve të një farmacie dhe të urgjencës në Paraburgimin e Beratit është urgjente.
14. Rekomandojmë DPB-së dhe Institucionet e Beratit, Burrel dhe “Jordan Misja” të marrin masat për asgjësimin ose tërheqjen e medikamenteve të skaduar të cilat gjenden në farmacitë e këtyre institucioneve.
15. Transferimi i të sëmurëve mendorë në institucionet e specializuara për këto sëmundje, si Institucioni për trajtimin e të sëmurëve mendore në Paraburgimin e Durrësit dhe Institucionit të veçantë të Zaharisë, Krujë, mendojmë se është një hap i domosdoshëm për të garantuar një trajtim mjekësor të specializuar për këta persona dhe për lehtësimin e punës të vetë administratës të këtyre institucioneve.
16. Përmirësimin e planeve mujore dhe ditore në grup dhe individuale në Institucionet e paraburgimit dhe të vuajtjes së dënimit, sidomos në IP Sarandë, Beratit si dhe rritjen e aktiviteteve sportive dhe edukuese.
17. Përsheptimin e procedurave nga DPB-ja për transferimin nga paraburgimi në institucionet e vuajtjes së dënimit të personave që marrin vendimin e formës së prerë.

### **Rekomandime drejtuar Ministrisë së Drejtësisë lidhur me sistemin e drejtësisë:**

1. Rekomandohet që të aplikohen më shumë dënime alternative nga Gjykatat me qëllim uljen e mbipopullimit në Institucionet përkatëse
2. Aplikimi i masave të tjera alternative të sigurimit të personit në rastet kur personat që akuzohen nuk paraqesin rrezikshmëri shoqërore.
3. Përsheptimin e procedurave gjyqësore me qëllim shmangien e zvarritjeve të panevojshme duke bërë kështu me eficient sistemin gjyqësor.
4. Aplikimin e dënimeve alternative dhe masave alternative për të miturit me qëllim rehabilitimin dhe integrimin e tyre. Proceset gjyqësore dhe ato hetimore të zhvillohen në një kohë sa më të shkurtër ku i mituri të qëndrojë në paraburgim sa më pak të jetë e nevojshme.

5. KSHH rekomandon Ministrisë së Drejtësisë që të marrin masat nëpërmjet rrugëve ligjorë për të detyruar gjyqtarët që kanë dhënë masat mjekësore të detyrueshme për personat që kanë kryer ose që akuzohen për kryerjen e një vepre penale, të rishikojnë vendimet e dhëna kryesisht bazuar në nenin 46 të KP. Gjithashtu të marrin masa që vetë administrata e burgjeve të iniciojë praktikat përkatëse në Gjykatë.

Tiranë më, 9 Nentor 2009